

## **Masat për të forcuar likuditetin e kompanive/ndërmarrjeve të cilat fillojnë të zbatohen menjëherë**

**Gjatë kësaj kohe të vështirë në të cilën gjithë ne jemi duke kaluar dhe që ka goditur rëndë shumë sipërmarrës, komuna e Eslövit ka vendosur disa masa pandemike në mënyrë që të mos përkeqësoj situatën tashmë të vështirë për sipërmarrësit tanë.**

Kommuna e Eslövit aktualisht ka vendosur të ndërmar masa siq vijojn më poshtë. Lista mundë të ndryshoj mvarësisht se si zhvillohet ngjarja me Corona virusin covid-19.

- Ne shtyejmë tarifatat dhe zgjasim kohën e pagesës për tarifatat vjetore të shërbimeve dhe licencave të alkoholit, të shërbimeve tjera të lejeve dhe mbikqyrjes si dhe ofrojmë shlyerjen e landës nëse ndonjë lëndë tërhiqet.
- Ne e zgjasim afatin kohor të lejes dhe mbikqyrjes po aq sa është e mundur.
- Ne japim përparësi lëndëve kritike të licencimit dhe mbikqyrjes.
- Ne zhvillojmë dialog për lëndët aktuale të licencimeve dhe mbikqyrjes. A dëshiron sipërmarrja/kompania të bëjë pauzë apo ta ndërprej veprimtarinë?
- Ne i shtyejmë vizitat e inspektimit që nuk janë kritike.
- Ne i shtyejmë tarifatat e mbikqyrjes së mjedisit dhe kontrollit të ushqimit deri në vjeshtë.
- Ne mundësojmë shtyerje/zgjatje të afatit të pagesës së qirasë të lokaleve komunale.
- Ne u përgjigjemi kërkesave të furnizuesve të mallrave dhe shërbimeve të komunës për shkurtimin e afatit të pagesave.
- Ne kemi qëndrim tolerant ndaj kontraktuesve tanë nëse anulohen konferencat, ligjëratat, udhëtimet etj. Për shembull duket i ndarë bashkarisht shpenzimet faktike.
- Ne lejojmë shërbime ushqimi në ambiente të hapura (jashtë restoranteve) gjatë gjithë vitit, shërbime të cilat janë falas nga 1 marsi e deri 30 qersori, një masë që mundëson shërbim ushqimi

jasht lokaleve me rrezik më të vogël për përhapjen e infeksionit.  
(Vini re se shërbimi i ushqimit jasht lokaleve kërkon leje/licencë nga policia)

- Ne ju japim shoqatave dhe organizatave tjera kulturore të drejtën që të anulajn kohët e caktuara me interval të shkurt dhe anulimi të jet falas.
- Ne ju japim dyqaneve mundësi ti qesin tavolinat në rrugë që të jen të dukshëm. (Vini re se për këtë duhet leje nga policia).
- MERAB mundet që gjatë rrethanave aktuale të lehtësoj sipërmarjeve, kompanive, organizatave dhe shoqatave të cilat dëshirojnë me e shtye afatin e pagesës së tarifës për marrjen e mbeturinave duke e pranuar një datë skadimi prej 90 ditësh pa kamatë dhe pa tarifa shtesë.
- Ne ju sigurojmë kompanive informacion të qartë, të azhurnuar dhe të pranishëm.

Mesazhi ynë për qytetarët: Mbështesni dhe promovojeni biznesin/afarizmin lokal.

Këto ndryshime dhe përpjekje vlejn deri më tutje, me qëllim që të jenë një mbështetje gjatë periudhës deri sa Coronavirusi Covid-19 është pandemi.

**Kontakta:**

Lars Persson, näringslivschef

Telefon: 0721-88 54 94

E-post: lars.persson2@eslov.se